

VENDIM
Nr. 652, datë 14.9.2016

**PËR RREGULLAT DHE KRITERET PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE NGA
GOMAT E PËRDORURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 41, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Menaxhimi i mbetjeve nga gomat e përdorura nënkupton rregullat dhe kriteret që përfshijnë mbledhjen/grumbullimin, transportimin, ruajtjen/ magazinimin dhe trajtimin e gomave të përdorura në mënyrë të tillë që të sigurohet mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe e mjedisit.

2. Në kuptim të këtij vendimi me termat e mëposhtëm nënkuptohet:

a) “Grumbullues”, personi që kryen grumbullimin e mbetjeve të gomave të përdorura.

b) “Magazinues”, personi që kryen ruajtjen e përkohshme të mbetjeve.

c) “Trajtues”, personi që kryen trajtimin e mbetjeve.

3. Të gjithë termat e tjerë të përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.

4. Ky vendim zbatohet për mbetjet e gomave të përdorura të mjeteve rrugore (ciklomotor, motomjete, automjete, trojlebus, rimorkio, makina bujqësore, makina teknologjike dhe mjete rrugore të veçanta), avionë dhe produkte të tjera të ngjashme, pas ciklit të jetës, të cilat zotëruesi i tyre i nxjerr nga puna ose kanë qëllim t’i heqin për shkak të dëmtimeve, fërkimit/gërryerjes ose arsye të tjera.

5. Zotëruesi i gomave të përdorura i dorëzon pa pagesë gomat e përdorura te grumbulluesi dhe/ose te magazinuesi dhe/ose te trajtuesi i gomave të përdorura. Në rastin e zëvendësimit të gomave të përdorura me goma të reja në pikat e servisit, zotëruesi i gomave të përdorura i dorëzon ato te servisi.

6. Grumbulluesi dhe/ose magazinuesi i mbetjeve të gomave të përdorura i dorëzon ato te trajtuesi i gomave të përdorura duke plotësuar dokumentin e transferimit të mbetjeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme.

7. Vendet e magazinimit të gomave të përdorura duhet të jenë të hapura dhe të kenë sipërfaqe betoni e të jenë të rrethuara nga një mur rrethues të paktën 2 (dy) m i lartë. Vendet e magazinimit për mbetjet e gomave të përdorura duhet të jenë të mbyllura.

8. Vendmagazinimi duhet të jetë nën mbikëqyrje për të parandaluar hyrjen e personave të pa-autorizuar dhe duhet të ketë një sistem për mbrojtjen nga zjarri, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

9. Menaxhimi i gomave të përdorura kryhet nga persona fizikë/juridikë, të pajisur me lejen e mjedisit sipas fushës III.1, të shtojcës së ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, dhe me licencën III.2.B, të fushës III, sipas vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar.

10. Trajtimi i gomave të përdorura dhe mbetjeve të tyre përfshin operacione, si më poshtë vijon:

a) Riveshjen për ritregtim, me qëllim përdorimin origjinal të tyre;

b) Riciklimin e gomave të patregtueshme, nëpër-mjet grirjes së tyre dhe përdorimit të granulave si lëndë e parë për industrinë e prodhimit të gomave;

c) Rikuperimin e gomave të patregtueshme me qëllim përfitimin e energjisë;

ç) Përdorimin e gomave të përdorura si lëndë djegëse shtesë për veprimtari të caktuara industriale.

11. Trajtuesi i gomave të përdorura dërgon pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve informacion në lidhje me sasinë e gomave/mbetjeve të gomave të përdorura, të trajtuara sipas dokumenteve të transferimit, brenda datës 30 tetor të çdo viti. Agjencia informon ministrinë në lidhje me të dhënat e trajtimit të mbetjeve nga gomat e përdorura brenda muajit janar të vitit pasardhës.

12. Grumbulluesi, magazinuesi dhe trajtuesi i gomave/mbetjeve të gomave të përdorura mbajnë regjistrime ditore për sasinë e gomave të përdorura të mbledhura, të magazinuara dhe të trajtuara. Regjistrimet ditore shënohen në një regjistër të posaçëm i cili ruhet për të paktën 3 (tre) vjet. Format i regjistrimit miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për mjedisin, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

13. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet juridike 3 muaj pas botimit.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi